



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER DATË
28.1.2021

Me datë 28.1.2021, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Në mbështetje të Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", ligjit nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive, mbledhja u zhvillua online. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Nersada Mandija, Aurora Dibra, Ardiana Ndreu, Diana Muriqi, Jona Leqejza, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Ardita Spahija, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Shllaku, Valbona Doniku, Jetmira Rraboshta, Lumniye Guri, Arvit Osja, Luan Heta, Elson Çeliku, Julian Kraja, Hilmi Lakti, Marjan Ndërshtiqaj, Gerald Hasaj, Lush Marku, Sokol Zaimaj, Lulash Nika, Besmir Vukaj, Anton Deda, Blerim Dimnaku, Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj, Nadir Spahija, Arbis Vjerdha.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.
2. Pr/ Vendim "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin dhjetor 2020"
3. Pr/ Vendim "Për miratimin e bursave për nxënësit e vitit të parë dhe të viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2020-2021"
4. Pr/ Vendim: "Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor për vitin 2021"
5. Pr/ Vendim: "Për miratimin e kërkesës së bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Zef Prendushi, Znj.Fehime Abdurrahmani, z.Alfred Caka, z.Shtjefën Caka, z.Hazir Dashi, banesat e të cilëve u janë dëmtuar nga zjarri"

6. Diskutime jashtë rendit të ditës

1.Mbledhja vijon me paraqitjen e rendit të ditës nga Kryetarja e Këshillit, ku paraqet edhe kërkesën e ardhur nga Kryetarja e Bashkisë për një shtesë në rend dite me dy pika:

- *Pr/Vendim për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët për vitin 2021.*
- *Pr/ Vendim për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato familje/individë që nuk përballojnë qiranë në tregun për vitin 2021 dhe miratimin e bashkëfinancimit për këtë program.*

Fjalën e kërkon Këshilltarja Jona Leqejza e cila propozon gjithashtu që pika 3. "*Pr/ Vendim "Për miratimin e bursave për nxënësit e vitit të parë dhe të viteve të dyta e lart të shkollave të mesme për vitin shkollor 2020-2021"* të shtyhet për një mbledhje tjetër pasi në sajë të verifikimeve të kryera për aplikantët, rezulton së një numër i konsiderueshëm aplikuesish që plotësojnë kriteret e VKM 666 nuk kanë arritur të paraqesin dokumentacionin në kohë për shkak edhe të kufizimeve të punës dhe radhëve në institucionet ku ato mund të drejtohen për tu pajisur me to. Kërkohet që diskutimi dhe vendimi të shtyhet për një datë tjetër për ti lënë kohe aplikuesve të paraqesin dokumentacionin e mangët.

Kryetarja e Këshillit kërkon dakordësinë e kryetarëve të grupeve, Znj. Dibra dhe Z. Sokoli të cilët e pranojnë rendin e ditës sipas propozimeve për shtesë nga Kryetarja e Bashkisë dhe propozimin për shtyrje të Këshilltares, si dhe propozon mbajtjen e një mbledhje të posaçme vetëm për këtë projekt akt me datë 10 shkurt 2021 dhe dhënie afati deri me 4 shkurt 2021 për paraqitje dokumentacioni.

Vijohet me miratimin e rendit të ditës nga ana e këshilltarëve me propozimet sa më sipër, ku në përfundim të procesit të votimit, rendi i ditës miratohet me 25 voto Pro, 0 Abstenim, 0 Kundër.

2.Mbledhja vijon me projektvendimin "*Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike.* ku fjala i jepet nënkryetares së Bashkisë znj. Emilia Koliqi, e cila relaton sipas materialit të përgatitur.

Në emër të komisionit i kërkohet mendim këshilltares, Znj. Nersada Mandia, njëherazi edhe kryetare e komisionit e cila shprehet se nuk duhen mbajtur në Këshill diskutime jo të plota sa i përket sistemit të vlerësimit të ndihmës ekonomike, pasi sistemi nuk është vetëm i paraqitur në pikëzime dhe renditje por paraqet një qasje universale socio-ekonomike për njerëzit në nevojë, dhe sugjeron mbajtjen e një seance tjetër ku njerëzit mund të sqarohen nëse kanë nevojë sa i përket sistemit të shërbimit social të ngritur. Këshilltarja Mandija, vë theksin se është shumë i rëndësishëm roli dhe përfshirja e administratorit shoqëror në asistimin dhe monitorimin e aplikantëve, por edhe për ti paraqitur atyre se nuk ka vetëm skemë ndihme ekonomike por ka mjaft të tjera, të cilave duhet ti jepet prioritet pasi ato synojnë punësimin dhe ri-integrimin e qytetareve, për të mos mbetur të varur nga skemat pasive. Znj. Mandija e sheh të arsyeshëm sistemin e pikëzimit të propozuar dhe shpreh qëndrimin e komisionit të çështjeve sociale duke i këshilluar kolegëve që të miratojnë projekt aktin.

Kërkon fjalën z. Sokoli i cili pyet nëse Bashkia Shkodër ka reflektuar zyrtarisht pranë Ministrisë përkatëse observacionet për sistemin e pikëzimit kombëtar. Fjala i jepet Nënkryetares Znj. Koliqi e cila shprehet se Bashkia Shkodër që në momentin e parë të ndryshimit të skemës së ndihmës ekonomike nga shërbimi social shtetëror nisur nga diferenca e madhe në numër përfituesish nga periudha e mëparshme dhe ka kërkuar sqarim për sistemin e pikëzimit tek shërbimi social shtetëror dhe drejtoria rajonale, po ashtu sqaron se KLSH ka bërë auditime për këtë shërbim, dhe në asnjërin nga rastet nuk kanë marre përgjigje dhe atyre u mbetet paqartësia. Znj. Koliqi vazhdon të mëshojë tek pikëzimi dhe jo aspektet e tjera të skemës.

Kryetarja e Këshillit u drejtohet Këshilltarëve nëse kanë diskutime dhe observacione specifike për këtë projekt akt. Nuk ka diskutime të tjera.

Kalohet në qëndrimet e kryetarëve të dy grupeve znj. Aurora Dibra dhe z. Gjergj Sokoli të cilët shprehen pro dhe mbështesin gjykimin e komisionit.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 28 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

3.Mbledhja vijon me projektvendimin *“Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin dhjetor 2020”*. Fjala i jepet znj. Emilia Koliqi e cila relaton sipas materialit të përgatitur.

Në emër të komisionit relaton Znj. Mandija e cila shprehet se komisioni sugjeron që të miratohet projekt akti. Kalohet në qëndrimet e kryetarëve të dy grupeve znj. Aurora Dibra dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen pro dhe mbështesin gjykimin e komisionit.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim 28 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kryetarja e Këshillit sugjeron të vazhdohet me diskutimin e projekt akteve të përfshira me shtesë në rendin e ditës duke qenë janë të lidhura me çështjet social ekonomike.

4.Mbledhja vijon me projektvendimin *“Peer miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato familje/individë që nuk përballojnë qiranë në tregun për vitin 2021 dhe miratimin e bashkëfinancimit për këtë program.”*

Fjala i jepet Drejtorit të drejtorisë për çështjet sociale, Z. Filip Vila i cili relaton sipas materialit të përgatitur.

Fjala i jepet këshilltares Nersada Mandija e cila shprehet se ky program është i dyti për strehimin në Bashkinë Shkodër dhe përshëndet nismën e Ministrisë për ta pajisur Shkodrën serish me fonde për strehimin social dhe përshëndet punën e shpejtë të kryer nga drejtoria për mbledhjen e shpejtë të informacioneve. Për këto arsye komisioni shprehet Pro këtij projektvendimi. Znj. Mandija sugjeron votimin në një raund për këto dy projekt vendime.

Kalohet në qëndrimet e kryetarëve të dy grupeve znj. Aurora Dibra dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen pro dhe mbështesin gjykimin e komisionit. Nuk ka diskutime të tjera.

Kryetarja e Këshillit vendos për votim të ndarë për secilin projekt akt por të merret parasysh relatimi i komisionit.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim 27 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

5. Mbledhja vijon me projektvendimin “Për përfitimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët për vitin 2021.”

Fjala i jepet Drejtorit të drejtorisë për çështjet sociale, Z. Filip Vila e cila relatton sipas materialit të përgatitur.

Kryetarja e Këshillit referon se do merret parasysh relacioni dhe mendimi i komisionit i shprehur në diskutimin e projekt aktit të mëparshëm dhe kërkon qëndrimin e kryetarëve të grupeve znj. Aurora Dibra dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen pro dhe mbështesin gjykimin e komisionit. Nuk ka diskutime të tjera.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6. Mbledhja vijon me projektvendimin “Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor për vitin 2021”

Fjala i jepet drejtueses së drejtorisë znj. Aida Shllaku e cila relatton sipas materialit të përgatitur.

Në emër të komisionit relatton Znj. Aurora Dibra e cila shprehet se mendimi i komisionit, bazuar edhe në diskutimet e mbledhjes së komisionit përkatës, është se ky plan është i domosdoshëm për të ruajtur këtë pasuri dhe ndërgjegjësuar një nga elementët më domethënës në dëmtimin e pyjeve, faktori njerëzor, dhe gjykon se plani është në përputhje me funksionet që ka njësia e vetëqeverisjes vendore dhe i përmbush nevojat e ruajtjes së pasurisë jo vetëm sipërfaqësore por edhe të biodiversitetit e cila është njësoj e kërcënuar, dhe vlerëson punën e bërë për të. Ndërkohë, znj. Dibra sugjeron që meqenëse ky plan është vjetor, të merren masa që të ketë një analizë më të shpeshtë përgjatë vitit. Komisioni rekomandon miratimin e projekt aktit.

Kërkon fjalën Z. Lakti i cili sugjeron të përfshihet tek plani edhe sipërfaqja e zonave të mbrojtura. Znj. Shllaku përgjigjet se këto të fundit janë tagër e Agjencisë së Zonës së Mbrojtura dhe ky institucion ka planet e veta për masat.

Kërkon fjalën Z. Sokoli i cili sugjeron që gjatë vitit të rriten aktivitetet e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e pyjeve. Znj. Shllaku sqaron se në plan janë 6 aktivitete.

Kalohet në qëndrimet e kryetarëve të dy grupeve znj. Aurora Dibra dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen pro. Nuk ka diskutime të tjera.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim. **Miratohet**

7. Mbledhja vijon me projektvendimin “Për miratimin e kërkesës së bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Zef Prendushi, Znj.Fehime Abdurrahmani, z.Alfred Caka, z.Shtjefën Caka, z.Hazis Dashi, banesat e të cilëve u janë dëmtuar nga zjarri”

Fjala i jepet znj. Emilia Koliqi e cila relatton sipas materialit të përgatitur.

Në emër të komisionit merr fjalën z, Hilmi Lakti i cili rekomandon miratimin e projekt aktit.

Fjalën e kërkon këshilltari Z. Anton Deda i cili pyet pse këto kërkesa vinë me kaq vonesë duke qenë se disa janë edhe raste të vitit 2019. Znj. Koliqi përgjigjet se ka qenë e vështirë të mblidhet i gjithë dokumentacioni i domosdoshëm nga familjarët dhe se situata e karantimit dhe masave shtrënguese për shkak të Covid 19 ka qenë e vështirë qasja në terren për të kryer verifikimet. Z. Deda pyet nëse ka raste të tjera dhe kur do të përfshihen dhe znj. Koliqi shprehet se në momentin që të mblidhen dokumentet do paraqiten kërkesat e reja për miratim në Këshillin Bashkiak.

Kalohet në qëndrimet e kryetarëve të dy grupeve znj. Aurora Dibra dhe z.Gjergj Sokoli të cilët shprehen pro. Nuk ka diskutime të tjera.

Kryetarja sigurohet për kuorumin e domosdoshëm dhe projekt akti hidhet në votim 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Nuk ka diskutime të tjera.

Nga ana e Kryetares së Këshillit mbledhja deklarohet e mbyllur

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 28.1.2021. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio (DVD)

Procesverbali përmban 5 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH

KRYETARE

Brisela KADIJA

KRYETAR I GRUPIT PSD

Gjergj SOKOLI

KRYETAR I GRUPIT PS

Aurora DIBRA